

KONTRATË SHIT- BLERJE KUOTASH

Sot, më datë 16/01/2019, ora 13:00, në Tiranë, në selin e shoqërisë "Qafa & Associates" sh.p.k: Rr. "Murat Toptani", Gjergji Center, Kati 6, Tiranë, u paraqiten personalisht palët e mëposhtme, të cilët redaktuan këtë kontratë shit- blerje kuotash me termat e mëposhtme:

Shitësi: z. **Ilir Qafa**, i biri i Napolon-it, shtetas shqiptar, lindur në Berat, më 09.06.1978 dhe banues në adresën: Rr. "Alla", Pall. Xheluks, Hyrja B, Kati 3, Ap. 8, Tiranë, identifikuar nëpërmjetletërnjoftimit nr. 033276346, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

Këtu e më poshtë Shitësit.

Blerësit :

z. Arkond Canaj, i biri i Ifran- it, shtetas shqiptar, lindur në Vlorë, më 19.06.1989 dhe banues në adresën: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit nr. BD4928997, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

z. Elton Beqiraj, i biri i Lavdosh-it, shtetas shqiptar, i datëlindjes 14.12.1975, vendlindja Durrës, banues në Durrës, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me mjetin e identifikimit kartë identiteti, me nr. personal H51214057U,

Këtu e më poshtë Blerësit.

Në zbatimi të nenit 73, 74 dhe 75 e vijues të ligjit nr. 9901. Datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, ligjt nr. 131/2015 " Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", dhe statutit të shoqërisë "Qafa & Associates" sh.p.k, të detyrueshme për tregtarët,

Bien dakord dhe shpreheni vullnetin e tyre për të lidhur këtë kontratë me kushtet dhe termat e mëposhtme:

1. Z. Ilir Qafa, është ortak dhe zotërues i 100 % të kuotave të shoqërisë "Qafa & Associates" sh.p.k., (me NUIS- L72414023E) ose 1 kuotë me vlerë të përgjithshme prej 10 000 (dhjetë mijë) lekë, kurse blerësit do të bëhen ortak dhe zotërues i 66,% të kuotave të shoqërisë "Qafa & Associates" sh.p.k., (me NUIS- L72414023E) konkretisht z. Elton Beqiraj do të bëhet ortak dhe zotërues i 33% të kuotave ose 1 kuotë me vlerë të përgjithshme prej 3 300 (tresmijë e treqind) lekë dhe z. Arkond Canaj do të bëhet ortak dhe zotërues i 33% të kuotave ose 1 kuotë me vlerë të përgjithshme prej 3 300 (tresmijë e treqind) lekë .
2. Shitësi nuk ka detyrime të pashlyera ndaj shoqërisë "Qafa & Associates" ,sh.p.k.

3. Nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate nga palët, shitësi humbet cilësinë e pronarit mbi 66 % të kuotave (2 kuotë) që ai transferon tek blerësit, dhe konkretisht 33% të kuotave (1 kuotë) që ai transferon tek blerësi z. Elton Beqiraj dhe 33% të kuotave (1 kuotë) që ai transferon tek blerësi z. Arkond Canaj .

4. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë sipas legjislacionit në fuqi nga titulli i pronësisë mbi këto kuota, objekti kësaj kontrate, që nga data e nënshkrimit të saj, i kalojnë



blerësi. Blerësi z. Elton Beqiraj bëhet zotërues me të drejta të plota të këtyre 33 % të kuotave (1 kuotë) në shoqërinë "Qafa & Associates" sh.p.k. Blerësi z. Arkond Canaj bëhet zotërues me të drejta të plota të këtyre 33 % të kuotave (1 kuotë) në shoqërinë "Qafa & Associates" sh.p.k.

5. Kjo kontratë hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga palët kontraktuese.

6. Palët zotohen se do të zgjidhin më mirëkuptim cdo mosmarrëveshje lidhur me këtë kontratë, në të kundërt, kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

7. Kontrata u hartua në katë kopje origjinale me fuqi të njëjtë juridike. Një kopje shkon për regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit, një kopje e merr shitësi dhe dy kopje i merr blerësit.

Palët

Shitësi

ILIR QAFA



Blerësi

ARKOND CANAJ



ELTON BEQIRAJ

